

INTERVISTË ME SALA AHMETAJN

Prishtinë | 10 qershor 2015

Kohëzgjatja: 107 minuta

Të pranishëm:

1. Sala Ahmetaj (E intervistuar)
2. Lura Limani (Intervistuesja)
3. Lirika Demiri (Intervistuesja)
4. Kaltrina Krasniqi (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Sala Ahmetaj: Unë kam lindur në fshatin Radishevë, komuna e Skenderajt. Është fshat tipik malor, pika më veriore, domethanë e komunës. Kam lindur në vitin, me 12 korrik t'vitit 1950. Fëmijërinë e kam kaluar natyrisht në fshat dhe kom pasur një fëmijë tipike të një jete në fshat të izoluar. Domethanë ku njerzit kanë jetuar më shumë si në familje, të gjithë. Sepse, domethanë, izolimi nga të tjerë... ka qenë një fshat shumë larg fshatrave tjera, pesë gjashtë kilometra deri te fshati më i afërt dhe i rrethuar vetëm me male. Kshtu që nga fëmijëria kam kujtime edhe idilike. Kemi mbajtur dele, lope, lojra tipike kanë qenë më shumë tradicionale.

I mbaj mend për shembull gjërat që shumë m'kanë lënë përshtypje, festat e Shën Gjergjit kur prindrit tanë sillnin gjithfarë lloj barishtash nga mali... ose dhe e zbukuronin shtëpinë. Na sillnin edhe neve nën jastëk, hitha u thonë, domethanë, e dini ndoshta {i drejtohet të pranishmëve} edhe barishta të tjera. Na lagnin me ujë, shumë herët në mëngjes.

Pastaj të gjitha vajzat e fshatit bëheshin bashkë, unë kom qenë shumë e vogël, sepse këto rite pastaj unë nuk kam mundur t'i shoh kur kom filluar t'shkoj n'shkollë edhe t'largohem nga... Po bëheshin bashkë, këndonin këngë, nuk e di si u thonë, domethanë në hulaja, i bënin vetë me konop edhe ndonji jastek aty. Babai shkante larg, është Mokna në bjeshkë afër Radishevës. Shkonin shumë larg për të mbledhur lloj barishtash të cilat duhej t'ua sillnin kafshëve n'mënyrë që ato t'kenë shëndet, ose gjatë verës. Këto janë gjërat që shumë m'kanë lënë përshtypje.

Edhe ni detaj tjetër. Babai im ka qenë autodidakt, domethanë ai nuk ka qenë i arsimuar. Edhe nëna gjithashtu. Dhe ata më tregonin, për shembull, është, n'ato rrethana babai im ka qenë ni dashamirës i madh i arsimit. Edhe unë kur kam qenë ndoshta tri-katër vjeçe, kom qenë fëmija i parë, pastaj kom pasur edhe tre vllëzër dhe ai m'thoshte, "Ti nëse mson mire, unë kom me t'çu n'shkollë". Qi ka qenë diçka, domethanë para 65 vitesh në një fshat malor. Dhe ai atë dashuri e kishte, domethanë, e kishte shtuar gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore. Sepse, kta, domethanë, në Kosovë në përgjithsi, ka pasë dramë t'madhe edhe n'atë luftë, sepse njerzit nuk kanë ditur nga t'orientohen. Me kë është më mirë t'jesh.

Edhe kta fillimisht, kanë shkuar, janë angazhuar në forcat e Legalitetit, u kanë thënë, në Pejë. Dhe babai im m'thoshte, "Unë aq shumë kam dëgjuar nga oficerët ligjërata", ne po u themi, ai u thoshte fjalime, t'mira. Edhe aty iu ka zgjuar dashurija për shkollën. Pastaj ata iu kanë folur për Skënderbeun, për historinë kombtare, për gjithçka. Dhe nga ai moment, ai e ka ushqy atë dashuri. Dhe për shembull, ai vllaut tim ja ka vënë emrin Skender, nga ato gjëra që i ka dëgjuar kur kanë qenë me ato forcat e Legalitetit. Ato pastaj janë shpërbërë. Dhe nga ai kom dëgjuar për shembull, ata përpara n'fshatra sidomos kanë kënduar shumë këngë epike, për Mujin, për Halilin. Domethanë, t'gjitha i kom ditur përmendsh ato, duke i dëgjuar çdo mbrëmje. Pastaj, Gjergj Fishtës për shembull, shumë dhe ato i kam ende nën ndërdije (qeshë).

Dhe, domethanë përveç tjerash... e pastaj, pasi janë shpërbërë kto, kanë qenë edhe aradhat partizane. Por për fat t'keq kështu m'thoshte babai. Tash unë nuk mund ta di të vërtetën plotësisht, po ai thoshte se në aradhat partizane, për shembull që kanë ardhur n'Kosovë, janë infiltruar edhe njerëz që kanë qenë çetnikë, që iu kanë thanë, që kanë qenë shumë nacionalista edhe shovinista. Dhe kanë vlarë aq shumë njerëz, në Drenicë sidomos, shumë, shumë... pa arsye. Pa bërë ndonji përzgjedhje ose... Dhe kjo ka qenë motivimi që Shaban Polluzha të organizojë, të bëjë domethanë ni lloj proteste kundër aradhave partizane. Sepse në fillim, kta kanë menduar se ata do t'jenë, edhe ata ndoshta do t'jenë çlirimtarët. Dhe në atë organizim ka qenë edhe babai im edhe shumë bashkëfshatarë t'mij. Disa janë vra n'atë luftë. Babai im ka shpëtuar, por domethanë ai ka pasur rrëfime të tmerrshme. Sepse ai thoshte, për shembull gjatë asaj kohe nëpër Skenderaj njerzit kanë ecur mbi kufoma, aq shumë. Dhe domethanë, edhe kanë qenë të hutuar çka po ndodhë domethanë.

Ai organizimi i Shaban Polluzhës ka qenë i... domethanë nuk ka pasur, ajo s'ka qenë ushtri e rregullt. Natyrisht, ai ka krijuar formacionet, batalionet. Unë e di, n'batalionin e parë kanë qenë njerëz e fshatit tim dhe ai që i ka udhëhequr ka qenë Ymer Fazlija, që është shumë i përmendur. Mirëpo, domethanë, ka qenë shumë e vështirë ni përpjekje e tyre për... Kjo ka qenë ni nga arsyet masakra që janë bërë. Po edhe aspekti ideologjik. Ata nuk e kanë dashur komunizmin. Dhe ai m'thoshte se Fadili, e ka pasur, Fadil Hoxha ni takim me Shaban Polluzhën në Skenderaj. Dhe ai përveç tjerash i ka thënë, i thotë, "Ne, domethanë nuk do t'ju sulmojmë në qoftë se ju i ndalni vrasjet". Ka pasur edhe aq shumë të burgosur aty, "Dhe në qoftë se ju i lironi kta". Dhe, ata që kanë pasur fat t'jetojnë, domethanë atë natë i kanë liru, sepse çdo natë i kanë vlarë nga ni numër t'caktuar që kanë qenë në burg.

Ni prej atyre që ka shpëtuar ka qenë daja, ni daj i imi, Ibrahim Spahiu, djali i Mulla Ilaz Brojës, ashtu është quajtur. Po ai ka qenë nga Kastrioti, tash i thonë. Dhe ai domethënë, ka qenë i arsimuar, n'atë kohë. E ka kry n'Shkup medresenë me Idriz Ajetin e kta. Dhe populli thotë, kush ka pasur fat t'jetoj... ai takim i Shaban Polluzhës me formacionet partizane, disa prej tyre kanë shpëtuar. Dhe, tash unë nuk i di detajet tjera. E di që kanë ardhur deri afër Podujevës. Janë sulmuar tradhtisht nga partizanët dhe aty janë vra shumë njerëz. Dhe pastaj ajo veç është shpërbërë si formacion.

Tash për fëmirinë time, unë vet si fëmijë kam shkuar në shkollë. Shkolla ka qenë... fshati im nuk ka pasur shkollë se ka qenë fshat i vogël, malor edhe është pesë gjashtë kilometra deri në Runikë, ni lokalitet. Dhe

unë atje, deri atje gjithmonë kemi shkuar n'këmbë natyrisht. Ni rrugë malore, ju nuk e dini, te ne thonë kah ecin vetëm dhinë, që është shumë zig zag, shumë përpjetë. Asaj rrugë, kom qenë e vetmja vajzë që kom udhëtuar nëpër mal, deri n'Runikë. Dhe atëherë binte shumë borë. Shumë interesant, tash bjen më pak, apo ndoshta ashtu m'është dukur mua (qeshë). Sepse për shembull, unë duke shkuar në shkollë, bora deri k'tu {prek gjurin me dorë}, deri mi gju. Dhe unë duhej ta qelja {tregon me dorë} rrenë i thonë, domethanë rrugën. A di sa vështirë.

Kom qenë shumë kureshtarë edhe si fëmi. Edhe, në shkollë natyrisht, atëherë msonim me klasë të kombinuara. Kur unë isha në klasën e parë, i msoja krejt msimet edhe t'nxënësve t'klasës t'tretë. Sepse i dëgjoja, domethanë ishim bashkë. Pastaj kur kom dalë... edhe unë, për shembull fustan, për herë t'parë n'klasën e pestë, e kom qepë vet fustanin. E kom ble materialin... e kom fotografinë, po nuk e di a do t'duhej ta... Edhe e kom ble, domethanë ni lloj basme¹ edhe e kom qepur. E kom fotografinë me shoqet e mia, unë e kom pasë veshur.

Aty ka qenë ni bibliotekë në... e ajo ka qenë si lokacion, jo qytezë, po ni fshat më... ka qenë si bashkësi lokale. E ka qenë biblioteka dhe une vazhdimisht merrja libra. Aq shumë libra kom lexuar, domethanë prej klasës t'pestë deri n'klasën e tetë. Edhe gjithnji, domethanë më zgjohej dëshira edhe për t'u arsimuar edhe për t'bërë diçka. Sepse une, domethanë atëhere edhe si fëmi, une e kom vrejtur se të gjithë kanë qenë t'paarsimuar, 80 përqind.

Unë, mësuese për herë t'parë kom pa kur... në klasën e gjashtë t'shkollës fillore. Erdhi nga Mitrovica, ni e re, domethanë sigurisht ajo ka pasur atëherë, nuk e ka pasur t'përfunduar krejt shkollën sepse kishte nevojë për njerëz që t'punonin. Edhe unë kur kam qenë n'klasën e gjashtë, ajo ka qenë shumë e bukur, Sanije Maliqi. Mund t'ua tregoj, e kom ni libër për mësueset e Drenicës. Dhe ne zgjateshim nga dritaret për ta shiku' si duket mësuese ni vajzë domethanë, se ne nuk kishim parë. Kemi menduar se vetëm mësues ka. Ajo me flokë kaçurrela, e bukur dhe unë kisha lexuar "Afërditën"² ndoshta dhjetëra here, t'Sterjo Spasse. E ka pasur në kopertinë ni vajzë me flokë kaçurrela. Më dukej se ajo doli nga romani dhe erdhi n'trajtën e njeriut aty (qeshë). Dhe ajo na donte shumë. Ka qenë shumë e dashur, shumë e mirë. Mua shpesh më merrte aty ku jetonte.

Pastaj, kur dola n'klasën e shtatë erdhën edhe dy arsimtare. Bile, madje, ajo arsimtarja tjetër ka qenë Fadile Zhubi, ni e Mitrovicës. Ato duke e pa edhe kureshtjen, ndoshta edhe dëshirën, domethanë më përkrahnin shumë edhe m'jepshin libra. Për shembull, kjo Sanija përgatiste edhe ëmbëlsira, lloj ëmbëlsirash që unë as që i kisha parë ndonjëhere. Se domethanë atëhere n'fshat është bërë vetëm ni lloj hallve, ndonji tomël-oriz ose... as bakllava. Domethanë shumë vonë kanë nisur këto të depërtojnë si...

Edhe, kur e mbarova klasën e tetë, babai im tha, "Tash ti do t'shkosh n'normale n'Mitrovicë". Ndoshta ju duket e pabesueshme. Ne shkumë n'kamë prej Radishevës deri n'Mitrovicë, i bie gjashtë orë këmbë. Edhe

¹ Basma është pëlhurë pambuku e hollë dhe me punim të thjeshtë, e ngjyrosur ose me lule të ndryshme.

² Është fjala për romanin e autorit Sterjo Spasse, "Afërdita përsëri në fshat".

kishim provim pranus'. Ka pasë shumë kandidatë sepse atëhere pak shkolla ka pasë t'mesme. Domethanë, Normalja ka qenë n'Mitrovicë edhe n'Prishtinë m'duket. S'ka pasë diku tjetër, nuk e besoj. Dhe tash, aq shumë ka pasë konkurrentë, unë kisha frikë a do t'pranohem a jo. Edhe pasi e përfundumë na thane, "Pas ni jave duhet të vini të shihni a jeni pranuar në shkollë, në Normale". Unë fjeta disa ditë, e kishte nana ime ni kushëri, ky Ibrahim Spahiu, edhe ndejta te ata. Kur shkova të shoh a jam pranuar ndoshta disa herë e kam shikuar listën dhe nuk besoj se jam pranuar. Isha e gjashta në listë (qeshë).

Edhe mandej u regjistрова në Normale. E kom mbaruar me sukses domethanë te shkëlqyeshëm. N'klasën e tretë ku kom qenë, m'kanë zgjedhë nxanësen ma t'mirë n'skollë. Edhe atëherë është botuar, ka qenë ni revistë "Front", për krejt Jugosllavinë. I kanë zgjedhur të shkëlqyeshmit nga krejt Jugosllavia. Merre me men' babai im e ka kuptuar nga drejtori i shkollës n'Runikë. Ai ka qenë malazez. Edhe kur e ka pa n'Runikë i thotë, Ali e ka pasë emrin babai im, thotë, "Ali, a ka qenë vajza jote?" "Jo", thotë, "ajo vjen shumë rrallë". Sepse atëherë autobusa nuk ka pasë. Nji mbushej n'Pejë edhe n'Runikë nuk ndalej fare. Pesë, shtatë, tedhetë njerz në ni autobus. E thotë, "Jo, nuk ka qenë moti". E thotë, "Prit pak se unë ka me t'tregu diçka t'mirë". Ai e ka pa atë revistën edhe i ka tregu, thotë, "Qe, vajza jote...", domethanë këshilli i arsimtarve të shkollës, e kanë... Edhe une kur shkova, prej dëshirës t'i tregoj, tha, "E, unë e kam kuptu" (qesh).

Mandej, kur kom dalë n'klasën e katërt, ma kanë mundësu t'i kry dy klasët për ni vjet. Kështu ka qenë atëhere, nxënset që kanë qenë, domethanë...

Dhe unë, menxi prisja, ni vjet para kohës domethanë fillova të punoja si mësuese në Runikë. Ajo ka qenë për mu ëndrra më e mirë në jetë. Edhe të gjitha të tjerat më vonë janë që i kam bërë, po jo diçka madhështore si ajo. Sepse mu plotësu' andrra për t'cilën unë me vite kisha... Dhe kom punuar disa vjet si mësuese aty dhe jom regjistruar në fakultet n'vitin 1971 me korrespondencë. Nuk i kom pasë kushtet ekonomike t'mira domethanë, për faktin se ata janë marrë vetëm me blegtori, atëherë s'ka pasë ndonji mundësi për... Edhe unë kisha dëshirë t'ju ndihmoja familjes që t'shkollohen vllaznit e mij edhe prindërve edhe u regjistрова me korrespondencë.

Po atë vit që une hyna n'punë n'Runikë, për herë t'parë erdhi energjia elektrike në Radishevë. Domethanë, sepse unë shkollën fillore e kisha kry me... atëherë i kanë thënë llampë me vaj guri, gas. E ngulsha ni gozhdë, te dri... te krytë {tregon me dorë}. Msoja me të derisa kisha mundësi, ose ditën. Edhe n'Normale gjithashtu, kur msojsha n'shpi. E te dajtë e mij, domethanë ishte diçka ni dallim i madh. Se n'Mitrovicë kishte edhe televizor, edhe m'kujtohet i shihsha disa seri amerikane atëhere. Edhe tash, ishte dallim i madh, domethanë nga jeta në qytet ose edhe në disa lokalitete që... Runiku kishte energji për shembull. Po ajo ka qenë zonë malore dhe shtëpitë e tipit t'shpërndamë edhe ka kushtuar shumë që t'sillej. Edhe unë si hyra n'punë erdhi domethanë energjia elektrike. Edhe unë e bleva televizorin tri ditë a katër pa u instaluar e tëra (qeshë) edhe e solla. Dhe ajo ishte ni gëzim jo vetëm për familjen time, po t'gjithë fqinjët vinin çdo mbrëmje ta shohin sepse ajo ishte diçka e veçantë, e parëndomtë për ta.

Ose për shembull gjyshja ime, ka qenë 90 vjeçe, nëna e nënës...Se as ata nuk kishin energji, Kastrioti tash Kostërrc është ni fshat. Edhe ajo, domethanë 90 vjeçe, ishte diçka ni tra...diçka e çuditshme për të, ose e pa imagjinushme a, ni trans kulturor. Dhe kur e sheh televizorin, tash fotografia kur vjen duke u rritur edhe ajo mendonte se dojnë t'dalin nga... Edhe thojke (qeshë), domethanë e vente shaminë nga frika se po e shohin. Na i thojshim, "Loke, ata nuk t'shohin ty. Jo!" Edhe tash e bënte, "Pasha shpirtin e..." për vllaun e vet ... "dolën!" I thojshim, "Jo!" Ose për shembull, në mbrëmje, vllau im i madh, ai është vllau, ka qenë ushtar tash n'luftë...edhe i thoshte, "Loke, a e lshojmë...?" Ai i thoshte shpija e madhe, se duke pa shumë njerëz edhe ish mbramje. Tash për ne ishte shumë vështirë t'ia shpjegonim domethënë.

Shumë interesant, ajo aq e vjetër edhe mu m'shikonte me shumë dashuri. E pëlqente atë... për dallim nga shumë që thoshin, "Jo s'është mirë se vajza priset kur shkon n'shollë", edhe fshati im, të gjithë. Ndosha është ndër fshatrat e rralla që nuk ka pasur fanatizëm, shumë interesant. T'gjithë kemi jetuar pa rrethoja, qysh i bojnë nëpër... pa gardhiqe që iu kanë thënë. Kanë jetuar, për shembull kanë ndenjur bashkë, e kanë prashitë misrin bashkë, kemi korrë bashkë grurë. Unë kam korrë si fmi, me drapën. Edhe nuk mund t'them se ka pasë shumë fana... s'ka... natyrisht disa elemente janë, kanë qenë për të gjithë të njejtë. Po jo n'atë kuptimin se unë pse kam shkuar në shkollë edhe jam bërë e dalë nga ato kodet e rëndomta.

Kanë qenë ndosha shumë arsye, se n'Radishevë tradicionalisht ka pasur shumë rezistencë ndaj Turqisë. Gjyshi im ka qenë i burgosur n'Turqi, dymbëdhjetë vjet. Mandej ka luftuar me Isa Boletinin bashkë edhe ka qenë kur është shpallë pavarësia. Është ni koiçidencë e çuditshme se sot bëhet rivarrimi i eshtrave të Isës. E gjyshi im, ka qenë bashkë me të edhe n'Podgoricë, edhe kur është vra Isa. Ky ka shpëtuar me djalin e Isës. E kanë sjellë edhe kalin e tij n'Kosovë. Kurse Isa është vra, djali i Isës edhe babai im kanë shpëtuar... stërgjyshi, kurse disa kushëri t'mij janë vra, dy bashkë me Isën. Ndoshta edhe këto mund t'kenë qenë arsyet.

Pastaj, Shotë Galica... është rritur n'Radishevë. Dhe, vet fakti se ajo ka qenë një luftare e parëndomtë për Ballkanin, jo vetëm për shqiptarët. Azemi i kishte edhe dy gra t'tjera, se shumë kanë pasur nga dy, tri gra, edhe Isa edhe... Por, Shota ishte ajo që u bë luftëtare, që e mori pushkën, që... Pastaj që e udhëhoqi çetën, domethënë edhe masi ka vdekur Azemi, ajo bashkë me ni kushëri Mehmet Delia e kanë udhëhequr disa vjet. Dhe ndoshta edhe këta faktorë kanë ndikuar që unë t'rritem me ni krenari t'them. Mu m'thoshin shoqet, edhe tash m'thonë, se unë i kam pasur domethanë n'Mitrovicë edhe sot vazhdoj t'i kem mike t'mira... Domethanë unë nuk kam pasur as pasuri po asnjëherë s'jam ndjerë e strukur, e ndoshta këta faktorë kanë ndikuar që unë t'jem... t'kem edhe ambicie mund t'them a, për të bërë diçka jo vetëm për vete. Edhe jam e lumtur (buzëqeshë).

Unë kam punuar dhjetë vjet në Runikë, domethanë në Runikë dhe Skenderaj pastaj, me krejt qenien kam punuar. Ndoshta energjinë ma t'madhe atje e kam harxhuar, edhe jam e lumtur për këtë. Për shembull, unë si mësuese... kemi organizuar gjithçka, gjithçka. Edhe orë letrare, kemi nxjerrë revista, edhe shfaqje, kemi dhënë vetë, unë kam lujtë role për shembull. Kemi bërë gara me shkollat tjera, n'kuadër t'komunës. Jemi përpjekur domethënë.

Mu, m'u ka dukur vetja, ndoshta nuk jam modeste në qoftë se e them, si misionare. Kam pasur dëshirë që shembulli im të ndikojë që t'shkollohen të gjitha vajzat tjera. Domethënë, t'u tregoj se ja që arsimimi ty të bënë vetëm më të dinjitetshme, më t'zonjën, më t'dobishme, për dallim nga bindja e përgjithshme që ka qenë. Ju jepja t'lexonin gjithçka, gjithfarë librash. A di sa librat i kom ble une atëhere? Me qindra! Për fat t'keq janë djegur t'gjitha. Se unë i pata lënë n'Radishevë, te vllazërit.

Edhe, domethënë... Pastaj kur e kam përfunduar fakultetin, kam qenë ende duke punuar atje, një herë mësuese n'Runikë, pastaj dy vjet profesoreshë n'Skenderaj. Ndoshta është me interes, se unë nuk di edhe çka është më mirë të [e intervistuar i drejtohet të pranishmeve] ...

Për shembull n'Skenderaj, n'viti 1976, atëherë veç pat filluar më shumë, domethënë, si ni lloj rilindje kombëtare... Kosova, atëherë ka filluar rilindja kombëtare, sepse ne kemi qenë shumë t'vonë... shumë, shumë. Unë kur e lexoj këtë librin {e intervistuar e tregon raftin e librave me dorë} për mësueset e Drenicës '41-'71, dhe n'vitet domethënë, '40-'48, të gjithë që kanë ardhur n'Drenicë nuk kanë qenë të Drenicës, ose nga Gjakova, ose nga Shqipëria, mësuesë ose mësuese. Domethënë ka qenë terr absolut.

Edhe në Skenderaj u hap fabrika e municionit. Kurrë s'e harroj, unë kam qenë profesoreshë. Domethënë ka qenë ni festë e pa rëndomtë nga gëzimi. Dhe unë iu dhashë nxënësve t'shkrujnë, të shkrujnë ni hartim atëherë u thoshim. Domethënë, titulli, "Sirenat e fabrikave po dëgjohen edhe në Drenicë, kjo nuk është legjendë".

Edhe pas atij viti unë kur kam përfunduar studimet, profesori Rexhep Ismajli atëherë ka qenë, provimet e fundit, edhe dy i kam pasur, edhe tha, "Ti vajzë...", atëherë na pytnin të gjithëve bashkë, në ni klasë, jo si tash (qesh). Edhe ka qenë gruja e Mehmet Krajës, Zize Rexhaj, njena n'Mitrovicë jeton, edhe shumë... Tha, "Ne duam të të ndalim në fakultet". Edhe une diçka... s'e kisha imagjinuar, ato mandej mu përçaf. Tha, "Edhe sa provime i ke?", unë i kisha edhe dy provime për ta përfundu. Tha, "Si t'i pëfundosh, ti do t'jesh ktu". Dhe, kjo është pjesa e rinisë sime. Nuk di a kam arritur, është vështirë njeri çdo... do të thotë të gjithë që dëshiron, ose noshta n'këtë moment nuk mund t'i kujtoj edhe gjërat tjera shumë t'rëndësishme (qeshë).

Pjesa e Dytë

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistesja e pyet të intervistuarën për rininë e saj.]

Sala Ahmetaj: Unë, domethënë kur kam ardhur në universitet... për shembull për herë t'parë n'Prishtinë kam ardhë kur jam regjistruar n'fakultet. Edhe rrugën ma ka vizatuar ni koleg. Kur kam zbritur, stacioni ka qenë te Televizioni tash ku është, kah Komiteti, tani që është Ministria e Kulturës, domethënë të kthehesh në të majtë, e tjera.

Po ndoshta rrëfimi im nuk mund t'jetë më i miri i mundshëm për faktin se unë kam studiuar me korrespondencë. Shoqet e mia kanë qenë të rregullta dhe une iu lakmoja. Por unë kam ardhur ndoshta

çdo javë, ose çdo dy javë të shtundeve. Ato rrinin në konvikt dhe mu m'dukej madhështore ajo pamje. Kjo është domethanë rilindje për mua. Kishte aq shumë vajza që studionin, dhe domethanë vullshëm. Dhe studionin domethanë në të gjitha degët.

Unë e di kur e kam mbaruar Normalen, m'patën thanë drejtori i shkollës, se atëherë që i krevia dy klasë me ni vit, atëherë u hap për herë t'parë Fakulteti i Mjekësisë. Edhe ai m'tha, "Ti n'mjekësi do t'shkosh". Nuk e kam dashur shumë, edhe une kisha edhe arsye tjera ekonomike edhe u regjistrova n'degën e gjuhës. Dhe une vija domethanë çdo javë, për mu ishte knaqësi shumë e madhe sepse largohesha nga një jetë provinciale, për shembull pa jetë kulturore. Jetën kulturore e bënin vetëm mësuesët ose arsimitarët me mundësitë e tyre.

Kur vija këtu knaqesha n'konvikt me shoqet e mija. Aq shumë vajza, aq shumë djem edhe domethënë... Ose për shembull, ne atëhere, ato i rezervonin biletat, çdo herë kur unë vija n'Prishtinë shkojshim n'teatër. Shfaqjet ma t'mira teatrale që janë shfaqë atëherë unë i kam pa, dhe kanë qenë jashtëzakonisht t'mira. Ndoshta mu m'duken tash po, domethanë... Pastaj dilnim n'korzo. A di sa bukur ajo, domethënë e pa përshkruar, si pamje, si përjetim.

Dhe kjo është, domethanë ka qenë lëvizje e përgjithshme kulturore, arsimore në tërë Kosovën sepse domethënë, ato efektet e para dolën atëhere n'vitet '70-ta... të mësuesve që erdhën nga Shqipëria edhe t'mësuesve që dolën nga Kosova. Dhe tani domethënë, ajo sikur, sikur bimët kur dalin dhe ishte domethënë ni lëvizje kulturore shumë e mirë. U formunë shoqëritë kulturoro–artistike nëpër shumë vende. N'Prishtinë domethanë, këto janë kujtime e mija më t'mira ose më t'veçanta. Për lëvizjen studentore unë nuk mund t'flas sepse unë kam jetu', domethanë nuk e kam jetuar të tërën. S'di ndonjë element çfarë mund t'them tjetër.

Lura Limani: Pra, ju keni qenë tu jetu' n'Skenderaj, a po?

Sala Ahmetaj: N'Radishevë.

Lura Limani: A n'Radishevë, ke udhëtu' çdo ditë...?

Sala Ahmetaj: Po, kam udhëtu', domethënë kur kam ardhë n'provime. Unë nuk kam qenë e rregullt, me korrespondencë. Vetëm n'provime edhe domethanë...

Lura Limani: Kur keni ardhë n'Prishtinë?

Sala Ahmetaj: Në Prishtinë, të jetoj?

Lura Limani: Ëhë.

Sala Ahmetaj: Domethanë, kur jam pranuar në fakultet, n'vitin, 1978-tën, atëherë edhe jam martuar (qeshë), edhe prej atëherë jetoj në Prishtinë. Ni detaj, për shembull une, kur e mbarova fakultetin edhe

atëhere, paketat e letrës, dhe i kishim përveç provimeve... ne edhe nga letërsia, edhe letërsi botërore ndoshta një qind libra është dashtë t'i lexoj, edhe i kisha... Tash për nënën time ishte e paimagjinueshme gjithë ato libra. Edhe une e regjistrova magistraturën, dhe tash ajo s'mund ta imagji... tha, "Unë kam mendu' që ti e ke përfundu shkollën, s'ka ma shumë" (qeshë). Sepse konteksi shoqëror ku kanë jetuar, nuk kanë arritur të kuptojnë se shkolla nuk ka... dija ose shkolla nuk kanë kufi.

Edhe... ose edhe ni element. Unë, nuk m'pëlqente emri im asnihere si fëmi. Dhe ne... unë shkova me babain tim të mbledhim sanë, e dini, domethanë bari kur teret, edhe kur kam qenë n'klasë t'tetë ndoshta, ose t'shtatën edhe thashë, "Babë nuk m'pëlqen emri", po tha, "Cilin emër ke pasë dëshirë?" I thashë, "Unë kam pasë dëshirë Shqipe ta kem emrin" (qeshë). "Epo", tha, "unë s'kam kry shkollë shumë, edhe s'e kam ditë që ta vë ni emër më t'mirë shqip" (qeshë).

Eh për shembull, pranimi im në universitet, edhe... se unë kam qenë e para me fakultet edhe prej djemve edhe prej vajzave në fshatin tim. Dhe unë gjithmonë kam nejtë n'odë me kushëritë e mij. Gjithmonë... krejt natyrshëm, domethanë ata janë krenu' për punën unë që kam bërë. Edhe kur jam pranuar n'universitet ka qenë domethanë festë për kushëritë e mij edhe për të gjithë. Diçka... sepse n'tërë ato fshatra prej asaj rrethine, askush nuk...

Kaltrina Krasniqi: A keni qenë gruaja e parë n'Universitetin e Prishtinës si profesor...?

Sala Ahmetaj: Jo, jo.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni me na folë pak për qat' periudhë?

Sala Ahmetaj: Periudhë... Nuk e di, ndoshta n'fakultetin tim... mund t'mos jem e saktë, po n'degën e gjuhës po, domethanë e para kam qenë. Edhe n'universitet, atëherë ka pasur pak gra. Po, për fat të keq, ajo... ai hovi ynë, n'vitet e 80-ta nuk zgjati shumë dhe n'vitet 80-ta u... dolën pengesat e para.

Domethanë deri n'vitin 1980-'81, ne kemi pasur ni jetë mjaft komode, ta them. Për shembull, ne për magistraturë shkojshim n'Biblioketë Kombëtare, kemi pasur vende ku t'lexojmë. Pas vitit 1980... deri atëhere, pastaj kemi qenë jashtzakonisht të kufizuar për shumë çështje sepse ndërroi konteksi shoqëror, sidomos pas demonstratave t'vitit 1981. Universiteti ka qenë më i atakuari sepse ata e quanin si kështjellë t'nacionalizmit, të irridentizmit. Nuk di tash n'çfarë konteksi mund të...

Lura Limani: A mundeni me na fol n'përgjithësi qysh ka qenë universiteti i organizumë edhe n'fakt qysh o' lidhë ajo me protesta, se i ka parapri lëvizjeve që kanë ndodhë në...

Sala Ahmetaj: Po ajo ka qenë, natyrshëm do t'vinte sepse n'Universitet... Universiteti ka qenë jo vetëm domethanë, vendi ku ne jemi arsimuar, po Universiteti ka qenë krenaria e Kosovës për faktin se aty ne edhe jemi edukuar. Edhe domethanë shkollën e civilizimit e kemi ngritur - e kemi kultivuar civilizimin në ni mënyrë. Jemi bërë më evropianë ta quajmë ose, domethënë është zgjuar vetëdija kombëtare. Për shembull, duke lexuar njeriu pastaj edhe vetëdijsohet më shumë për të drejtat edhe për... domethanë jo

vetëm për të drejtat tuaja personale po edhe për të drejtat kolektive, për të drejtat kombëtare. Dhe, domethanë ne, studentët, profesorët kanë qenë kuadër jashtëzakonisht i mirë edhe idealista kanë qenë të gjithë dhe kanë punuar me idealizëm. Dhe domethanë, ajo punë që nuk ka qenë vetëm t'mësosh ni msim, ose ni lëndë, ose ni provim, po domethënë...

Ata profesorë, Anton Çetta për shembull, po e marr ni prej emrave, ose të tjerë, na e kanë kultivuar edhe dashurinë për kombin, për atdheun, për lirinë. Dhe unë e kam parë, edhe unë, edhe shumë kolegë t'mi t'asaj gjenerate, e kemi parë se neve domethënë na mungon liria kolektive, liria kombëtare. Sepse ne e shihnim, si për shembull serbët kanë pasur më shumë privilegje, kanë qenë të gjithë nëpër poste dhe ne atëhere, domethanë vetëvetiu e shihje. Dhe ai kontekst i përgjithshëm shoqëror që u krijua është kontribut i Universitetit të Prishtinës. Shumica e kuadrove kanë qenë të shkolluar domethanë në Zagreb, në Lubljanë dhe atje kanë marrë edhe ni kulturë më evropiane, më... dhe ajo ka ndikuar domethënë që edhe studentët duke lexuar më shumë e tjera, të vetëdijsohen më shumë për të kërkuar të drejta më të mëdha kombëtare.

Unë këtë vetëdije e kam pasur edhe më herët, edhe të tjerë ndoshta ka pasur. Se njeriu kur e përjeton edhe në familje, domethanë e ke diçka që e ke parë nga fëmijëria. Unë kom pasur ofertë, për shembull kur e kam mbaruar Normalen, që të vija në Komitetin Krahinor të Rinisë, sepse u mbajt ni Konferencë në Skenderaj, dhe e kom ende të shkruar me dorë fjalimin që e kam mbajtur për shkollimin e vajzave. Edhe atëhere, domethanë ata më përzgjedhën mua që t'jem n'kryesi dhe t'kem ni post t'randisishëm. Unë hezitova tre muaj dhe nuk erdha. Dhe më qortonin njerëzit atje sepse domethanë kisha edhe përfitime materiale, po domethanë ajo bindja ime se ai nuk ishte shteti im, domethanë nuk... nuk e gjeta veten edhe nuk kom pas ardhur domethanë. Dhe kur m'kanë parë pas shumë vitesh n'Universitet, n'vitin '81, kur qenë ato trazirat, njëri m'tha, "Ti paske ardhur n'vend më t'mirë se sa ku kemi dashur ne. Po ne kemi dashur të të largojmë nga provinca se e kemi pa se ke mundësi të arrish më shumë. Dhe nga frika se do t'mbetesh vetëm mësuese..."

Tash, pikërisht vitet e 70-ta, janë vitet ma t'arta dhe krejt kjo që kemi arritur sot është rezultat i punës së Universitetit në vitet 70-ta. Nga viti... domethanë kur është themeluar, deri n'vitin 1981, sepse pastaj Universiteti ka qenë gjithmonë i ndëshkuar dhe gjithmonë i mbikqyrur ta quajmë.

Lura Limani: Ju personalisht, a keni qenë... a e mbani mend ndonjë episodë sidomos gjatë protestave?

Sala Ahmetaj: 81-shit? Po, unë i kam pasur vëllezërit studentë n'vitin 1981. Une e kom pasë lindur atëhere vajzën e dytë edhe kom qenë n'pushim t'lindjes. Dhe, domethanë vëllezërit e mij kanë qenë në protesta edhe përveç... nga tërë Kosova edhe dy kushërira t'mija. Dhe, domethënë unë... shkoj burri im të shoh... ata nuk erdhën tek unë as në konvikt, sepse krejt konviktet kanë qenë të rrethuar nga policia. Dhe vëllai im pastaj e ka pa se nuk ka mundësi edhe e kanë pa veten t'rrezikuar. Nuk kanë shkuar n'konvikt fare edhe erdhi tek unë, unë u shlirova. Vajzës time i lotojshin sytë mrena në dhomë nga tymi që kanë hedhur. Merre me men'! Dhe ne kemi banuar në ni banesë private, se ende nuk e kisha banesën

time. Atje ajo lagjja, domethanë si i thonë, nuk e di... duke shkuar për Podujevë, atje. Dhe aq larg i lotonin në dhomë, gjashtë muajshe vajza ime, i lotonin sytë nga tymi. Dhe, kur erdhi vllau im, ni detaj t'ua them, ata prapë dilnin, se domethanë kur njeriu përpiket për ni ideal humbë frika (qeshë).

Edhe thërrasin, thonë, "Jo, e kanë burgosur Salën", për mua. Sepse e kanë ditur se unë, atje domethanë kam qenë pak nën mbikqyrje të policisë. Sepse edhe kur kemi qenë në Shqipëri, në vitin 1973, domethanë na kanë marrë në pyetje, sidomos për mua se unë kom lexuar aq shumë libra atëhere, aq shumë.

Dhe ni dajë i imi më thotë, "Thuaj vllait tënd, Skenderit, mos te vesh më xhemperin që e ka pasë me vija..." Sepse domethanë njerëzit, prandaj unë nuk kam dëshirë të... edhe ata që kanë punuar atëhere, disa prej tyre domethënë kanë dhënë kontribut. Dhe dikush ka qenë në ato t'sigurimit ose të policëve. Tash krejt fotografitë që i kanë bërë, n'bazë t'fotografive i kanë identifikuar edhe i kanë zënë n'rugë ose kudo që i kanë gjetur njerëzit. I kanë thënë, "Preji floktë krejt edhe mos e vesh xhemperin", sepse dikush i njofshëm i tij i thotë, "Ai po vrehet shumë mirë". Dhe une ia kom hedhur xhemperin, i ka shkurtuar flokët për t'i shpëtuar burgut. Unë vet nuk kom qenë pjesë e... sepse i kom pasë rrethanat. Ndonji detaj tjetër s'po di çfarë mund të...

Lura Limani: N'rregull është. A mundeni me na tregu pak ma shumë për jetën e juaj profesionale. Domethanë, na tregutë se keni punu' si msuse n'Runikë, masnej edhe n'Skenderaj si profesoreshë edhe përfundimisht që...

Sala Ahmetaj: ...n'Universitet, po.

Lura Limani:... që keni punu n'Universitet. E lamë te magistratura. Nëse mundeni me vazhdu?

Sala Ahmetaj: Po, po. Domethanë unë, kur jam pranuar në Universitet, pastaj e kam regjistruar magistraturën. Mu atëherë m'pat zgje... përzgjedhur domethanë për lëndën e Sintaksës Hilmi Agani, edhe ka qenë shumë i ashpër. Dhe të gjithë m'thoshin, "Ti ke pasur fat që je e përzgjedhura e Hilmi Aganit". Po lënda, Sintaksa nuk ka qenë shumë e parapëlqyer prej... Edhe unë e mora domethanë Sintaksë temën e magistraturës. Kur e përfundova, e regjistrova doktoratën.

Por atëhere ndodhën... koha, vitet e 90-ta kur na larguan nga institucionet. Une dhe disa kolegë t'mij, jemi viktimi e asaj kohe. Dhe ne pastaj në ni n'mënyrë hoqëm dorë. Edhe pse e kishim t'regjistruar sepse... ka ndoshta edhe që kanë doktoruar n'atë kohë, po ne domethënë, n'atë kontekst shoqëror në Prishtinë ka qenë shumë vështirë. Nji, s'kishe zyrë, s'kishe bibliotekë, s'kishe ku punoje. Dy në shtëpi, domethanë çdo ditë ka ndodhur diçka e rëndësishme që unë patjetër doja ta dëgjoja, ose ta shihja ose... Domethanë ka qenë vështirë të gjesh koncentrim për të punuar.

Ne kemi, n'kuadër të Fakultetit t'Filologjisë është organizuar edhe Seminari Ndërkombtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Ndoshta kjo ka qenë e arritura më e madhe e Universitetit, për at' kohë. Sepse seminari ka qenë e vetmja dritare prej nga ne e kemi parë dikë nga bota, ose bota e ka parë

Kosovën. Domethanë, për ne ka qenë interesant kur e ke takuar ni francez, ni gjerman, ni... Domethënë, ndoshta edhe kemi menduar se ata janë ndryshe, janë... edhe ata janë njerëz, tash e dijmë. Po domethënë, për ne ka qenë kureshtje e paparë ajo. Domethanë, përveç rënsisë shkencore, kulturore, arsimore, ka qenë e rënsishme edhe kjo. Sepse ne domethënë, kishim takime me njerëz që vinin për t'mësuar gjuhën shqipe. Dhe ne kemi, unë kom qenë vazhdimisht pjesë e Seminarit. Njihere me kurse t'gjuhës, pastaj n'Drejtorinë e Seminarit, përgjegjëse për referime nga fusha e Gjuhësisë, anëtare e Këshillit Drejtues t'Seminarit. Viteve t'fundit edhe ofertë për udhëheqje, nuk kom pasur dëshirë edhe kshtu domethënë.

Mirëpo, n'vitet e 90-ta, ata na e ndërprejnë Seminarin, edhe Seminarin. Natyrisht, ne kur ishim nëpër shtëpi private, nëpër... ka qenë e pamundur ta organizojmë ni gjë të tillë. Dhe për dy vjet rradhazi e kemi mbajtur n'Tiranë, n'vitin 1995 edhe 1996. N'95-tën, edhe n'92-tën do ta tregoj ni detaj. A ka munësi, para ksaj, se m'u kujtua [e intervistuar, i drejtohet të pranishmeve]. Për shembull, n'vitin 1992, u mbajt 20 vjetori i Kongresit t'Drejtshtkrimit, n'Tiranë. Dhe ne kemi qenë të ftuar, dega e Gjuhës Shqipe dhe Instituti Albanologjik. Dhe ne tash... rrugën na e pagoi ni agjension. Ka qenë "Sion Tours" m'duket, i Mitrovicës. Ata na çuan pa pagesë deri në Shqipëri edhe na kthyen knej. Po ne deri n'Maqedoni shkum' me pasaportë. Prej Maqedonisë deri n'Shqipëri, me letërnjoftime. E keni t'qartë, n'mënyrë që t'mos të... Dhe ata na i fshehën diku pasaportat, nuk e di ku mrenda n'autobus. Dhe atje pastaj kufinin Maqedoni – Shqipëri e kemi kaluar me letërnjoftime. Dhe kemi në 100 vje... në 20 vjetorin e Kongresit të Drejtshtkrimit.

Kurse, për Seminar, n'vitin 1996 unë kom shkuar nga Turqia në Shqipëri sepse unë kisha domethënë... sepse e kisha ni vulë të Shqipërisë në pasaportë. Kur kemi hy... Edhe tash kur jam kthy këndeje, nga Shqipëria, kam fjetë ni natë në ni fshat të Kumanovës, n'kufi, Llojan. Madje ni ginekolog e ka pasë nxënësen time, domethanë i martuar me ni n'nxënësen time t'Skenderajit dhe familja e tij pastaj m'kanë sjellë deri n'Preshevë. Ilegalisht, jo nëpër kufij, nëpër ara. M'kujtohet me traktor, thashë, "A e kalumë?" Tha, "Hiç mos u mërzit se n'tokë t'Serbisë je" (qeshë). Edhe, domethanë edhe kto kanë qenë sakrificë. Domethanë, për t'bërë ni punë ne duhej të bënim ni flijim të tillë.

Edhe n'Shqipëri... ose për shembull unë kom qenë e ftuar për 100 vjetorin e lindjes t'Naim Frashërit. Na e patën dërguar domethanë Akademia e Shkencave t'Shqipërisë. Dhe kolegët e mij e kishin pasaportën domethanë n'Prishtinë, une duhej n'Mitrovicë t'shkoja. Edhe e pamundur, domethanë nuk na munsuan të shkojmë. E për seminar në këtë mënyrë domethanë kom shkuar.

Për t'bërë shkencë t'mirfilltë, ka qenë shumë vështirë. Edhe pse domethanë na... fushat e ndryshme janë... domethanë gjuha nuk ka kërkuar mjete t'veçanta për ekspe... e tjera. Po nuk kemi pasur muni të kontaktojmë, të shohim... edhe pse ne literaturën të tërën, ka qenë e përkthyer serbisht. Nëse ndonji t'mirë e ka pasur që kemi ditur serbisht ka qenë se krejt literatura botërore, e gjuhësisë botërore ka qenë e përkthyer n'serbisht, ose kroatisht, ose... Dhe mua, për shembull burri im, atëhere e studionte grafikën

n'Beograd, m'i sillte t'gjitha. Ke qenë ni Benvenist, gjuhëtar i njohur, t'Sosyrit, Xhon Llajons,³ e tjerë domethanë, në këtë mënyrë.

Po ne kemi arritur të krijojmë kontakte me Universitete të tjera me... Megjithate, Seminari na ka ndihmuar shumë. Dhe ne e kemi vazhduar pastaj, pas luftës, meniherë n'vitin e parë pa asnjë mjet. Ne para luftës, as s'kemi pasur ndonji shpërblim. E kemi bërë vullnetarisht. Edhe pas luftës, derisa është... janë formuar institucionet tona t'Kosovës. Domethënë, Ministria pastaj na ka përkrahur. Po...

Pjesa e Tretë

[Pjesë e prerë nga video: intervistuesja e pyet të intervistuarën të vazhdojë të flasë për jetën e vet profesionale.]

Sala Ahmetaj: Po për shembull, mas vitit 1981 ne kemi qenë edhe t'kufizuar, edhe të kërcënuar, në ni mënyrë. Aq shpesh ka pasur mbledhje, për shembull në fakultet. Aq shpesh kanë kërkuar prej nesh që të distancohemi nga domethanë, nga veprimet e studentëve, nga protestat, nga... Ne nuk e kemi bërë ni gjë të tillë. Nejse, katedra jo... fakulteti jonë ndoshta më specifik. Sepse katedra jonë kanë qenë të gjithë shqiptarë. Edhe tash nuk mund t'di... ose edhe dega e letërsisë... Ka qenë katedra e serbo-kroatishtes po nuk kam ndonji kujtim sepse s'kom pasur kontakte me ta. Mirëpo, domethënë gjithmonë kemi jetuar me tension, tension të vazhdueshëm.

Edhe, për shembull, ni detaj, ne me gjithçka të kufizuar, ne atëhere... ndanin banesa për profesorë, për arsimtarë. Edhe m'kujtohet, Universiteti i kishte disa banesa që... dhe tash Drejtoria që ka qenë e... domethanë për ato çështje, thotë, "Ju... nëse nuk i paguan Universiteti pjesën e mbetur, ne do t'ua marrin t'gjitha banesat". Merre me men! 60 përqind kanë t'paguara nga Drejtoria për Ban... çka ka qenë ajo e Komunës. Ajo e ka pasur për detyrë të gjitha, se ashtu kanë vepruar gjithmonë. Po domethënë ky ka qenë ni nga mënyrat që ne t'kemi edhe... domethënë edhe materialisht, edhe domethënë jetën tonë ta kemi shumë më t'vështirë, që t'dëshprohemi, që... Dhe tash ato banesa ne duhej ose t'i blejmë vet, t'i shtojmë ato para ose humbnin.

Dhe m'kujtohet ka qenë Hasan Mekuli, dekan atëhere n'fakultetin tonë edhe thotë, "Ju që s'keni banesa, më mirë është t'i jepni 40 përqind, merrni hua ose kredi, ose... sepse ato të tjerat që i kemi... që i ka dhënë Universiteti edhe Bashkësia e Banesave, humbin. Këta po na kërcënohen!" Dhe ai ka qenë kërcënim. Domethënë, ai ka dashur që unë t'mos kem as mirëqenie materiale, as shtëpi, as banesë, asgjë dhe... Domethënë, kanë përdorur të gjitha mjetet.

Edhe domethanë... ose për shembull, sidomos pas vitit '90, n'vitin '90, ku u suprimu' autonomia e Kosovës, kanë qenë ditë shumë të vështira për ne, shumë, shumë, shumë. Edhe shumë interesant është,

³ E intervistuar e ka fjalën për linguistët Emile Benveniste, Ferdinand de Saussure, dhe John Lyons.

për shembull atëhere neve na largonin nga puna të gjithëve. Edhe, së pari i larguan ata që kanë qenë në Komision për pranimin e studentëve, dy, tre. Pastaj, me grupin e dytë... edhe ne shkonim çdo ditë të gjithë bashkë. Të detyruar kemi qenë të shkojmë çdo ditë në fakultet, ose ne kemi qenë të detyruar të shkojmë në konvikte, t'bëjmë kujdestari.

Unë, ç'është e vërteta, u knaqësua me studente, as që kemi diskutuar për çështjet për t'cilat ne shkojshim. Se ata thojsin, "Ju duhet t'i kontrolloni studentët" dhe ne kemi mbajtur kujdestari. Çdo ditë me rradhë profesorët, secili nëpër konvikte t'caktuara, t'krejt Universitetit. Kanë qenë shumë t'mundimshme ato. Dhe unë shkojsa kujdestarojsa për shembull... natyrisht ne nuk e kemi kry detyrën që ata kanë menduar se duhet ta kryjmë. Që tu themi se, "Ne i kemi kushtet e mira, ne i kemi të drejtat e mjaftueshme", e tjera, s'u kam thënë kurrë. Dhe ato studentet, për shembull, pija kafe me to, bisedojshim për letërsi, për... ose për gjëra tjera.

Mandej, ne duhej t'shkonim çdo ditë në fakultet, çdo ditë, dhe të prisnim çka po ndodhë. Tash pas... pasi që i përjashtunë ata që kanë qenë... domethënë pretekstet. Tash grupi i dytë... me grupin e dytë u përjashtova unë. Pse? Sepse ne kemi qenë në protestë bashkë me studentë para fakultetit. Dhe unë e kam madje ni faqe gazete, aty dukemi shumë mirë. Domethanë, une n'kamë, disa gra ma t'vjetra, edhe vishin edhe pleq edhe të gjithë njerëzit. Edhe tash, ata natyrisht e kanë ditur kush jemi. Mandej, n'atë protestë tymi aq shumë më pat munduar.

Edhe tash ne na larguan, grupin e dytë pse kemi qenë në protestë, bashkë me studentë. Ndoshta kjo është e arritura më e madhe kur profesorët e thynë heshtjen. Domethanë, edhe ne, natyrisht ne në heshtje... publikisht nuk jemi deklaruar, po atëhere domethanë ne dolëm. Edhe tash, me rradhë i larguan shumicën e profesorëve. Edhe, metën vetëm disa. Dhe tash ata nuk ndjeheshin mirë, sepse ti mbeteshe me masat e dhunshme. Tash ata kërkuan... disa u larguan vetë pastaj. Ndonji rrallë ka mbetur për ni kohë ndoshta. Po shumica u larguan vetë.

Dhe ne pastaj u riorganizuam. Dhe m'kujtohet n'Institut Albanologjik e mbajtëm tubimin fakulteti ynë. Edhe i zgjodhëm organet tjera, na vet domethanë. Edhe vendosëm që domethanë ta vazhdojmë msimin nëpër shtëpi. Për fat t'keq, shumica e shtëpive kanë qenë... ajo pjesa kah rruga Xhemajl Ibishi, a i thojnë... është shkolla nuk di si quhet, "1 Maji" ka qenë ose... nuk e di si quhet, "Nazim Gafurri" ose... shumë larg. Kryesisht klasat kanë qenë si t'parapara për depo ose për lokale, krejt n'cimentë, me tulla. Edhe besomë, m'dhimbeshin studentët. Për shembull, ai ulej në ni tulle, edhe e mbante librin në prehër. Shumë ftoftë, gjithmonë.

Unë reumë kom, po m'duket prej atëherë e kom shumë më shumë. Edhe prej atëherë kom filluar t'veshi pantallona edhe gjithmonë i veshi. Se ne e keni pasur bindjen, profesoresha, mësuesja duhet të vishet me kostume, më klasike më... Tash unë prej Dardanisë, ku e kom banesën, deri n'Xhemajl Ibish, ndoshta ni orë e 20 minuta, 15 minuta une shkoja n'këmbë. E mbajshim msimin. T'ua them t'vërtetën, shumë

studentë që atëherë kanë qenë shumë t'mirë. Për shembull këta t'ritjë që janë n'katedrën tone, janë prodhim i asaj kohe. Shumë interesant.

Mandej, edhe policia filloi t'na ndiqte, për shembull aty ktu t'i largojnë nga... Edhe m'kujtohet ni kolegë Murat Blaku ka qenë, po m'thotë, "Salë...", tha, "policia..." Tash une aty ku kisha, ku unë duhej me mbajtë msim, tha, "te unë erdhën edhe qyshtu m'pytën". Thashë, "O Murat, mos m'trego kurgja se mu su m'pysin çka t'kanë pytë ty, as s'po du me mbajtë men' fare. N'ardhshin..." Domethënë, rrethana shumë delikate.

Ni kohë, domethanë s'kemi marrë fare paga. Mas ni kohe kah 50 marka atëherë kanë qenë. Edhe vajzat e mija kanë qenë, sidomos e treta, shumë e vogël. Edhe ndonjihere m'thoshte... i thojsha, "Jetë, kësaj radhe kom shku n'kamë, edhe tash unë ato që kom pasë për rrugë po t'i jap ty". Se fëmijtë lunin bashkë me shoqë kështu, edhe ka qenë si natyrë pak më... Ka pasë dëshirë t'ketë ndonji lodër, ndonji...

Domethanë, përveç kësaj, rrethanat n'cilat kemi punuar, domethënë kanë qenë t'paimagjinueshme, e pa imagjinushme sa vështirë. Shumë studentë pastaj mbetën... se dikur nisi lufta edhe tash, sidomos rajoni i Drenicës edhe Dukagjinit... Unë e di, tash m'kanë ardhur disa... unë ju pata thanë, "Jam e gatshme t'ju marr, ose t'ju jap çkado që kom une mungsi, n'qoftë se kemi mbetur pa para, ose..." Se ata, ju humbi kontakti me familjarë.

Njeriu ndonjihere... tash çuditëm për shembull për motivin e madh që e kemi pasë. Asniherë nuk jam ndi e lodhur. Ka pasë rast, për ni student unë kom shku deri atje, që ka pasë ose provim diplome, ose ndonji provim. Sepse m'dhimbsej, e disha që ka ardhë domethanë... e ka pasë shumë t'vështirë deri sa t'vij, ose deri... Ose ndonjihërë i kom thirrë në shtëpi, n'banesën time. Sepse m'dhimbeshin, ftoftë. Ndonjihërë, për shembull edhe pronarët kanë qenë shumë t'mirë, shumë, 80 përqind e... po disa edhe mungsi s'kanë pasë m'i nxehtë ato lokale.

Edhe une, shumë shpesh i kom thirrë n'shtëpi, edhe pse s'kom pasë ni komoditet t'madh. Sidomos n'provime, i kom thirrë në shtëpi, shumë shpesh. Edhe tash, ata paraqiten vet kur m'shohin ndonjihere, ose... Kjo ka qenë domethanë kohë e mbijetesës. Edhe nëse asgjë s'kemi bërë, ose nëse nuk kemi arritur në planin arsimor të bëjmë më t'mirën, ne e kemi ruajtur ni kohezion. Edhe, domethanë i kemi larguar t'rijtë nga rruga, nga dëshpërimi, duke shpresuar se do t'bëhet mirë. Dhe mendoj se e kemi bërë mire, n'ato rrethana n'cilat kemi punuar.

Dhe kur më kanë larguar nga puna, mos t'harroj ta them, ka qenë hera e parë që jam gëzuar që nuk i kom pasur prindërit e mij gjallë. Për faktin se domethënë në ni kontekst shoqëror ku kanë jetuar, ata kanë qenë shumë të lumtur që fëmijtë e tyre, se edhe vëllaun e kisha profesor n'Universitet, edhe ai... Edhe ne tash me gjithë atë mund, me gjithë atë sakrificë për ta mbaruar shkollën, për t'punuar, na largojnë nga puna. Ka qenë diçka shumë e vështirë për ta. Edhe për ni fakt tjetër - sepse kur, domethanë kur u prish krejt situata dhe nisi t'shpërbëhej Jugosllavia, ne ende shpresonim. Unë idealiste edhe thojsha, "Jo more s'kanë çka na bëjnë".

Edhe babai im, pa ni ditë shkollë, sepse ate jeta e ka msu' që domethanë duhet t'i kemi disa gjëra tjera, jo vetëm shko... domethanë jo vetëm t'jesh i arsimuar, po t'i kesh domethënë t'rregulluara me ligje të drejtat tua. Dhe m'kujtohet atëherë kur, domethanë kur ne mbanim mësim kshtu edhe unë thojsha, "S'kanë çka na bojnë kta". E di, nejtëm deri në mëngjes, e shikojshim televizorin, Kongresi i Jugosllavisë kur u shpërbë Jugosllavia. N'pesë t'mëngjesit dolën kroatët, sllovenët. Edhe na prapë me shpresë që... E babai im më pat thënë, "Po m'dhimni shumë, por dine, ju nuk keni asgjë. Edhe mrena tri ditësh, krejt çka keni do t'i marrin. Sepse ju s'keni ushtri, ju s'keni polici. Ju keni shkollë, por nuk mjafton ajo. Domethanë, ju jeni t'arsimuar shumica, po nuk i ke institucionet që ty t'mbrojnë". Dhe qashtu ndodhi. Po ai nuk ishte gjallë domethënë m'u vërtet'u fjalët e tij.

Ose nëna ime për shembull, unë jam çuditë atëhere, tash çuditem. Ne s'kemi ditë për Shqipërinë atëhere aq shumë domethanë. Nuk i kemi pasur t'gjitha t'dhënat që Shqipëria nuk është e fortë, nuk mund t'na ndihmoj... Edhe nëna ime tha, "Kurgja puna e Shqipërisë". "Pse, nanë?" "Se s'po ju ndihmon kurgja, a pe sheh çka po hiqni". Domethënë, ne kemi qenë t'arsimuar po disa prej nesh, domethanë kemi besuar se edhe do t'ia arrimë t'gjitha pa e bërë këtë sakrificën e madhe. T'cilën u desh ta bëjmë. M'kujtohet t'huajt për shembull, na thoshin, "Ne kemi protestuar para Universitetit". Edhe m'kujtohet, oh zot, sa i... Ose me një tetor, për shembull atëhere. Unë kom dalë, burri im ka dale, të gjithë.

Kaltrina Krasniqi: '97 – tën?

Sala Ahmetaj: Po, edhe kemi protestuar. Edhe t'huajt thoshin, "Mirë, a ka vdekur ndonji para Universitetit?" Domethënë e keni bërë ni sakrificë, po jo më t'madhen. Dhe domethënë, pastaj konteksti e sollë që duhej ta bënim edhe... se luftën askush nuk e do.

Lura Limani: A po na... e përmendët shumë mirë se pa sakrificën e madhe nuk ka mund me u ndrru', me u hekë Kosova prej okupimit serb. A po na tregoni ju për përvojën e ju, po supozoj prej viteve... prej '97 – tës, '98 –tën edhe gjatë luftës?

Sala Ahmetaj: Po, po. Ajo është domethanë periudha më e vështirë e jetës sime, ju kërkoj falje (qanë). Familja ime ka qenë e tëra e angazhuar në luftë. Vëllau im i madh ka qenë ushtar. Domethanë, kur kanë qenë celulat e para n'Drenicë, unë i kam takuar. Edhe kur n'Prishtinë askush se ka ditur se ka ushtri, madje mendonin se janë vetëm supozime, ose janë fjalë të propagandës t'Serbisë, e tjerë. Edhe unë shkova në Leqinë, ni fshat është n'kufi me komunën e Istogut. Ni kushëri i imi, me mua shkuam n'këmbë, edhe thashë, "Unë, du t'i shoh të gjallë", domethanë si... ushtarët. Është e çuditë... ndoshta 70 përqind e tyre kanë qenë nxënës t'mi në Runikë, se Leqina është afër Runikut. Edhe ata të gjithë po m'përqafin, "O, mësuese", thashë, "shikoni, kësaj rradhe unë duhet t'përulem para jush, jo ju para meje" (qanë).

Mandej, vëllau im, prej '94-tës ka jetu gjysmë n'ilegalitet, sepse n'94-tën e kanë marrë policia natën në shtëpi. Ka qenë me gru dhe me fëmi. E kanë arrestu' edhe aq shumë e kanë torturu' sa që e kanë hedhë buzë rrugës, si kanal në ni vend, t'u mendu se është i vdekur. Dhe rasisht... domethanë jeta a, rasisht duke kaluar, dy njerëz e shohin, e marrin edhe e shohin që është i gjallë. Edhe mandej me këto lëkurat e deleve,

me ato mjekimet tradicionale e kanë shëru' pjesërisht, e kanë gjetë dikun ni mjek edhe e kanë majtur të fshehur.

Dhe vjen ni kushëri tek unë, prej Radishevës n'Runikë, me m'tregu', sepse është frigu' se unë e dëgjoj n'lajme edhe për mu është shokuse domethanë. Edhe, thashë, "Unë jam t'u shku' n'msim", kishim atje n'Xhemajl Ibish. Dhe ai për mos me m'tregu para vajzave t'mija tha, "Po vij me ty", tha, "edhe shkojmë bashkë edhe..." Dhe gjatë rrugës më tregoi. Tha, "Une du' me t'marr ty me ardhë me mu, me pa Kapllanin". Unë, kur e kom pa vëllaun tim, kom thënë, "O zot, a është e mundur që mund ta përballojë njeriu..." Atij nuk i dihej dora që e ka dorë, as kamtë as... Krejt, krejt si m'ia mbushë me ujë. Domethanë nga... që është ajë shumë, edhe t'u e majtë me çarshafa.

Edhe domethanë ai ka qenë shumë idealist, jashtëzakonisht idealist. E ka studiuar historinë, por domethënë nuk e ka përfunduar. Edhe, m'tha, "Ti, shko. Ti, detyra e jote shumë ma e randsishme atje ku je, se sa me nejtë. S'ki pse rrin me mu këtu". Mandej është shëruar dhe është angazhuar domethanë n'luftë. Edhe në '98-tën, kur ka ndodhur... unë kam qenë, kom pas shkuar n'varrim në Likoshan. Këta, domethanë janë brengosur, pse s'u ktheva e andej, ju thashë, "Unë..." Edhe atë natë kom fjetur në Skenderaj. Ni kushërirë e imja m'tha, "Motra Salë, ti duhet neser t'kthehesh sepse...", ata e dinin, tha, "krejt serbët po largohen. Edhe këtu ka me ndodhë diçka tragjike, e madhe". Edhe unë atë ditë, prej mëngjesit jam nisë atje, nashta n'tetë n'mramje kom mbrii memzi, me... herë kambë, herë me diçka dej n'Mitrovicë, mandej këndej.

Kur kom mbrii atë natë në Prishtinë, n'ora pesë t'mëngjesit ajo m'ka thirrë n'telefon edhe tha, "Po shkon flakë te Jasharajt edhe njofto këndo që munesh". Vlora ka qenë atëhere 17 ose 18 vjeçe, ka shku i ka thanë Fehmi Aganit edhe të tjerëve domethanë, n'mënyrë që të alarmohet s'paku. Unë, vëllaun tim e kom pa mas disa ditësh që ka ndodhë kjo. Unë nuk jam besimtare n'kuptimin... më shumë anoj nga ateizmi, po unë jam bindë qi ka diçka, ose ndodhin gjana qi ti... Edhe unë kur jam përshëndetur me vëllaun tim, besomë, kur jam kthy, i kom thanë burrit tim, "Unë nuk ka me pa ma Kapllanin". Mu ka dukë qi krejt... kom pasë ni trazim qi nuk disha me përshkru. Edhe i thashë edhe vëllaut tjetër, thashë, "Skendë..." Edhe ashtu ka ndodhë.

Domethanë, ai është vra n'gusht, e kanë marrë policia kufomën, e kanë çu' n'spital edhe ndoshta nuk është mirë t'ju lëndoj me këtë rrëfim, është shumë i dhimbshëm, edhe s'di sa... Edhe, Liri Loshi ka qenë ni... e kom pasë nxënës n'Skenderaj, shumë i zoti. Ai e ka dhanë n'lajme atë natë vrasjen e tre ushtarëve nga Radisheva edhe unë e kom ditë qi njëri prej tyre është vëllai im. Ai tha, "Unë nuk kom pasë forcë t'i përmend emrat, se kur e njeh personalisht dikun është shumë ma vështirë". Kom shkuar n'Mitrovicë, edhe ni mjek që e bënë obduksionin, ka thonë... domethanë kudo njerëzt kanë kry edhe ni detyrë humane. Ai i ka marrë t'dhanat edhe i ka tregu ni... dikujt, thotë, i ka shënu, edhe thotë, "Kapllan Ahmetaj është i vlarë dhe është mirë ta dijnë familja". Për shembull, ma mirë qi e kom kuptuar atëherë sesa t'mendoj se është i zhdukur, t'jetosh me ankth tërë jetën. Është edhe ma vështirë.

Dhe mu ai, jam takuar më ka treguar, ni plumb e ka pasur këtu, ni këtu {tregon me dorë ballin dhe gjurin}, dhe ka vdekur në vend. Kufomën nuk na e kanë dhënë. Sot e atë ditë ne nuk kemi arritur ta bëjmë rivarrimin, është përtej urës t'lbrit. Edhe ai është preng i statusit t'Kosovës, domethënë edhe kufoma e tij (qanë). Sepse unë nuk kam dashur t'shkoj ta marr n'mënyrë ilegale. Pse t'i rrezikoj njerëzit tjerë, domethanë derisa t'rregullohet. Përafërsisht e dijmë ku është i varrosur.

Edhe vajzat e mija kanë qenë t'angazhuara shumë, e madhja dhe e dyta. Dhe une deri n'njimdhetë t'natës rrija në terasë a po kthehen. Kur na kanë larguar nga banesa, ndoshta ka qenë domethënë ni ndër momentet më të rënda. Jo për shtëpinë time po pse e leja Kosovën domethanë. Kjo është ni prej sakrificave domethanë, sepse n'Kosovë ka shumë rrëfime të vështira. Vëllau im s'paku nga plumbi, se në fshatin tim ka pasur shumë t'vrrarë. Përmenden ato qe kanë qenë fshatra t'mëdha, po aty përmasat e popullsisë me t'vrrarët janë tragjike. Dhe ni djalë i axhës tim, e ka pasur djalin 16 vjeç, Alban emrin. Dhe ai shkonte n'Mitrovicë këmbë me na tregu neve, për shembull për luftën për... i ri fëmi. Dhe atë e kanë prerë policia {tregon me dorë qafën}. Domethënë vetëm lëkura i ka mbetë. Ai dhe shumë tjerë, i kanë masakru. Dhe i kemi gjetur domethënë pas disa ditësh.

Natyrisht, unë jam e lumtur që sot rinia e Kosovës jetojnë pa këtë trishtim. E di që s'është gjithçka n'rregull, po s'paku domethanë koha i zgjedhë edhe këto çështjet tjera, se...

Pjesa e Katërt

Lura Limani: E përmendët që ju kanë përzanë prej banesave, rreth kohës së Bajramit, çka... pastaj po supozoj keni shku n'Maqedoni. A po na tregoni çka ndodhi pas daljes n'Maqedoni edhe kur jeni kthy vullnetarisht n'Kosovë?

Sala Ahmetaj: Domethanë në Maqedoni, ne... atje na kanë pritur jashtzakonisht mire edhe s'kemi pasur ndonji vështirësi në planin domethanë, gjërave elementare që i duhen njeriut. Mirëpo, kemi jetuar me ankth - çka po ndodhë dhe kur po kthehemi. Unë nuk kom pasur dëshirë të dal jashtë të... po kemi pasur dëshirë të kthehemi në Kosovë dhe disa oferta nuk i kemi shfrytëzuar. Momentin që ka hy NATO-ja, Vlora u kthy atë ditë me trupat e NATO-së n'Kosovë. Edhe kanë nejtë tri netë n'Grand, krejt t'rrethume me tanke, këta që kanë ardhë NATO-ja, nga frika që mos ka ende paramilitarë ose... Edhe ajo na tha, "Nanë, mos u ktheni ju se s'ka as ujë as rrymë, kurrëgjja n'Prishtinë". Na nuk... çfarë, kush me na nalë (qeshë).

U nisëm dhe ka qenë ndoshta pamja ma madhështore n'jetën time. Me qindra makina, me qindra traktora, kolonë tu u kthy n'Kosovë. Edhe une as s'e kom ditë për banesë çka ka ndodhë, as s'isha ngushtë me thanë t'vërtetën, edhe jemi kthy domethanë mas tri-katër dite, ndër t'parët që jemi kthy n'Kosovë jemi ne. Dhe ai i Tetovës ku kanë nejtë vajzat, se ne n'Ohër kemi qenë me burrin, domethanë e mushi makinën me gjithfarë ushqime, na solli, gati për ni mujë na kishim rezerva kur erdhëm. Domethënë ajo dehja e lirisë, domethanë... nuk zgjati aq shumë dhe pastaj filloi jeta reale.

Filluan, ne filluam punën në Universitet. Nuk gjetëm asgjë, as librat, as në fakultet kurrë se harroj, domethënë shumë... Po, filloi edhe domethanë organizimi politik. Une vazhdova domethanë t'punoja edhe për doktoratë. M'ofruan ofertë që t'angazhohem në politikë. Kom hezituat shumë. Unë e kom përcjellë politikën kështu pasivisht, po vetë ndoshta nga bindja se domethanë njerëzit që janë shumë t'sinqertë edhe t'çiltër është më vështirë, domethanë edhe sot mendoj ashtu, është më vështirë që të... ta ushtroj profesionin në politikë. Vazhdimisht m'kanë ardhur n'shtëpi edhe dikur u binda, domethanë n'Partinë Demokratike atëhere. Arsyeja ka qenë se ajo ka qenë vijë politike që edhe familja ime... domethanë e ni rezistence më aktive. Jam zgjedhë deputete n'mandat... domethënë fillimisht në komunën e Prishtinës. Zgjedhjet e para kanë qenë lokalet, një vjet. Dhe atëherë kanë qenë me lista t'hapura po më të ndershme se si kanë ditur shumë...

Kaltrina Krasniqi: N'cilin vit?

Sala Ahmetaj: N'vitin 2000, m'duket... po se 2000... po 2000, 2001 pastaj 2004, 2004-2007 këtu. Edhe mandej m'propozuan për deputete n'Kuvendin e Kosovës, n'vitin 2001. Domethanë, ajo ka qenë ni përvojë e imja e jashtëzakonshme, edhe domethanë ni ëndërr që unë kom pasur mundësinë ta përmbush. Ne kemi punuar shumë, sidomos mandati i dytë. Edhe kanë qenë deputetët jashtëzakonisht të përgjegjshëm. Për shembull, ligji i parë n'Kuvend që është miratuar ka qenë Ligji për Arsim. Edhe une kam folur n'emër t'grupit parlamentar për Ligjin për Arsim. Natyrisht, ne kemi pasur shumë mangësi. Nuk kemi pasur përvojë t'organizimit t'shtetit. Nuk kemi ditur, shumë gjëra s'i kemi ditur, deri edhe tek këto çështjet e kurtuazisë, ose t'mënyrës t'komunikimit, ose...

Domethanë, kemi punuar rreth hartimit të ligjeve, debate për çështje politike. Për shembull ka qenë përmbushja e standardeve para statusit, që për mu ka qenë diçka shumë e rëndë. Edhe m'kujtohet, ato diskutime, unë kah një javë i përgaditsha, edhe tani bëjnë shaka, "Nanë, ti sikur kur i shkrunë punimet për..." (qeshë). Domethënë nga frika që nuk po jom e përgjegjshme... Edhe tash ajo çështja e përmbushjes t'standardeve para statusit, domethanë gjithmonë prej nesh është kërkuar diçka që të tjerët nuk e kanë bërë ndoshta. Dhe unë e kom pas përmendur në ni nga fjalimet e mija, "Cilin standard e ka përmbushur Greqia për shembull për të drejtat e shqiptarve n'Greqi?" Domethanë, për grekët, shqiptarët, s'ekzistojnë ose... dhe ata janë në Bashkimin Evropian. Dhe pastaj, mu disa kolegë m'thanë, "Eh ti nuk bënë shumë diskutime politike", n'kuptimin...

Po ne vazhdimisht domethanë... nga politika kom msuar shumë gjëra. Nji, unë e kom parë pastaj vetë... se unë kom qenë idealiste dhe kom menduar se gjithçka mund t'arrihet ashtu si ti do. E aty e kom parë se na nuk kemi mjaft fuqi, se domethanë, gjithmonë aleancat funksionojnë. Edhe n'qoftë se je i mirë, edhe n'qoftë se ke kualitete si komb ose si popull, edhe n'qoftë se lufton shumë, qoftë se nuk arrin t'krijosh aleanca, nuk mund t'ia arrish qëllimet. Domethanë, unë aty e kom parë, për shembull me diskutime shumë t'vështira, shumë... sepse domethanë, duhej t'bëheshin balancime, duhej domethënë... Dhe mandej nga idealistja kom... jam bërë pragmatike edhe më realiste se e kom parë se nuk mund t'bëjmë krejt çka na takon. S'mund ta arrish vet, shumë vështirë është pa pasur aleat ose miq në planin politik.

Na patën çuar edhe në ni shkollë politike në Strasburg, dhe aq shumë kom msu' aty. Po atëherë m'dukej shumë e vështirë, se ka qenë shumë afër koha e luftës domethanë. Sepse për t'arritur ni pajtim, ose ni... megjithate kërkohet një kohë. Dhe ata na flisnin për shembull si janë pajtuar gjermanët me francez ose... Dhe në Universitet e patën mbajtur ni... meniherë mbas luftës, ni si lloj tryeze, edhe na folën, profesorëve t'Universitetit, na folën për çështje politike. Ni belge, ni holandeze, ni... edhe ai ka qenë domethënë menihere, 2000 viti, shumë afër. Dhe ne disa... unë e bëra ni pyetje, ua bëra. Edhe m'kujtohet, ni koleg i degës së frengjishtes, Halit Halimi, tha, "Profesoreshë, m'ke knaqë. Shumë mirë u ke thënë" Tha se... unë u thashë, "Plotësisht, ju mund ta keni, domethënë nuk e kundërshtoj këtë pajtim që e kanë arritur, por për çdo pajtim kërkohet domethanë që palët duhet të jenë të barabarta edhe viktima duhet të shërohet pak, e jo domethënë kur ende une kom plagë shumë të thella edhe e kom plagën e hapur". Thashë, "Si mendoni ju?" Dhe unë këtë pyetje ua pata... dhe ai kolegu, ai m'patë thënë, "Gjithmonë, kafen do ta kesh nga unë sepse është e..." domethënë...

Pastaj, si deputete domethanë kom parë se politika ndonjihere edhe t'zhveshë pak nga humanizmi, s'po di, ose edhe nga arsyeja. Se për t'arritur qëllimet politike, ti, edhe për ni çështje që ndoshta është e mirë, ti nuk e bënë sepse don ta... kundërshtarin ta... unë si... s'm'duken shumë... shumë korrekte. Kom punuar edhe, domethënë si... jam angazhuar shumë sa kom qenë deputete edhe për çështje të barazisë gjinore. Dhe ne kemi punuar shumë për hartimin e... për planin nacional t'barazisë gjinore, planin kombëtar. Ne e kemi bërë, disa deputete dhe me domethanë, kanë qenë t'Kombeve t'Bashkuara, Unifemi, ajo domethënë. Dhe e kemi bërë ligjin, unë jom një nga hartueset e ligjit për barazi gjinore.

Domethanë, çështja e barazisë gjinore, unë, edhe disa shkrime i kom pasë t'botuara n'Kohën Ditore, po edhe i kom lexuar domethanë Simonë de Bovuar e tjera. Kur kanë qenë diskutimet edhe rreth kuotës... Në ni vend si Kosova, domethanë unë kom qenë e bindur se barazia nuk mund t'arrihet... natyrisht ligji duhet të bëhet por duhet t'ketë edhe domethënë promovime të strategjive tjera për vetdijësim kolektiv. Se nuk mundet vetëm ligji, ligji shumë gjatë shkon koha n'qoftë se ti nuk ke ni kulturim të përgjithshëm, ose kur nuk promovon ide që e shpërfaqin barazinë gjinore. Tash, kuota e detyron domethanë, i detyron institucionet që t'i fusin edhe gratë. Tash, a hyjnë ato të merituarat, a t'pamerituarat, ajo është çështje tjetër. Unë mendoj se derisa ne ta arrijmë ni vetdijësim më cilësor, duhet t'mbetet kuota.

Për vendet skandinave nuk ka nevojë t'ketë kuotë sepse domethanë atje ka arritur natyrshëm barazia gjinore. Dhe për barazinë gjinore ne duhet të punojmë që nga çerdhja, nga familja, nga shkolla, në tekstet shkollore. Unë e di, vajza ime m'thoshte, "Pse nanë vetëm babi qet' çaj? Asnji burrë tjetër nuk qet' çaj." Sepse ju ka dukë atipike ajo. Tash edhe burrat tjerë kanë qenë t'arsimuar, kanë qenë profesorë, ose inxhinierë ose... Domethënë se shumë vështirë ndërron vetëdija. Edhe ti tash, që ta ndrron vetëdijen duhet t'promovosh sa më shumë, domethanë edhe me projekte t'ndryshme, edhe me... domethanë t'bësh promovim të barazisë ose me shembuj konkretë, ose me mjete tjera, jo vetëm me ligj.

Pas mandatit t'dytë, une domethanë kom pushuar t'merrem me politikë dhe u bë mirë sepse pastaj e mbarova doktoratën, sepse do t'më mbetej peng. Domethanë ni punë që e kisha nisur shumë më herët

po unë dhe disa kolegë t'mijë kemi qenë edhe viktimë e rrethanave jashtë nesh. Kom botuar shumë punime shkencore nga sfera e gjuhës, nga fusha e sintaksës, nga norma e shqipes së shkruar. Ato janë punime, domethanë që i takojnë në sfera të ngushtë profesionale, shkencore. Vazhdoj të punoj në Universitet dhe gjithmonë e kom bërë me dashuri sepse e kom adhuruar arsimin. Tani, besoj e kom përmbushur misionin tim dhe para disa ditësh, të ni televizioni më morën në një intervistë, edhe tha, une thashë, "Atëherë, kemi menduar se duhet t'bëhesh vetëm mësuese. Për fat t'mirë, tash domethënë zhvillimi është bërë shumë më i madh edhe më i mirë sepse tani femrat mund të kryejnë funksionet nga më të ndryshmet. Sepse atëherë kanë qenë fillimet e arsimimit, kurse... po edhe se kishim shtetin tonë. Tani ti mund t'bëhesh gjyqtare, mund t'bëhesh juriste, mund t'bëhesh gazetare, mund t'bëhesh sociologe, mund t'bëhesh regjisore, aktore, domethanë të gjitha profesionet e mundshme". Dhe domethanë edhe promovimi i barazisë bëhet në këtë mënyrë. Se kur je e pranishme gjithkunj, ti je edhe... domethanë edhe barazia arrihet më mirë.

Unë madje edhe n'politikë, nuk m'pëlqejnë këto organizimet. Unë ju kam thënë, po ju dukej... Për shembull, Forumi i Gruas, ç'është ajo? Pse t'kesh Forum? Ti duhet t'kërkosh t'i kesh 40 përqind në Këshillin Drejtus të ni partie, jo të kesh Forumin e Grusë dhe folin vetmeveti gratë. Çka është ajo? Ose ta kesh ni, për shembull, i ke sektorin për arsim, për barazi gjinore, n'kuadër të sektorit për kulturë ose për arsim dhe ti aty e promovon, e bënë ni grup që punon. Po jo të jenë të ndara domethënë. Tash edhe kreatorë edhe... domethanë mund ta kryesh çdo profesion të mundshëm që ty të pëlqen ose mund ta bësh. Dhe në këtë mënyrë promovohet më shumë barazia gjinore.

Natyrisht... se mua më patën thënë, ta zëmë... nuk mund t'kesh ti... çështja e barazisë gjinore në kuadër... nuk mund t'kesh as gjinore barazi, pa e pasur këtë lirinë e përgjithshme. Ajo është kupola. Dhe ti pastaj në kuadër të ligjeve, të kushtetutës, e tjerë i promovon barazinë gjinore. Po liria kombëtare është kupola. Dhe është më e rëndësishmja, n'kuadër të së cilës ne i domethanë... profesionet tona, dhuntitë tona i përmbushim duke respektuar ligjet dhe parimet e drejtësisë, të humanizmit, vlerave.

Kaltrina Krasniqi: E kam ni pyetje. N'kohën... ju keni qenë pjesë e Parlamentit n'kohën kur osht' prezentu ideja për kuotën.

Sala Ahmetaj: Po...jo!

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë ajo, se ish' dashtë prej fillimit...

Sala Ahmetaj: Po, po. Prej fillimit ajo ka qenë.

Kaltrina Krasniqi: Çfare ka qenë atmosfera n'Parlament prej kolegëve t'jujë, prej... faktikisht, se e di që ka qenë debat shumë i ashpër.

Sala Ahmetaj: Shumë i ashpër, une bile e kom ni shkrim atëhere. Domethanë, vlera a kuota? Të dyjat, unë e dua edhe vlerën edhe kuotën sepse vlerat e mija ndonjiherë nuk mund të dalin në sipërfaqe pa

kuotë, për faktin se ne ende kemi ni shoqëri, ndoshta jo tradicionale, po më shumë maskuliste. Natyrisht, në Prishtinë më pak hetohet, po edhe n'Prishtinë. Në familje, nuk them 80, po ndoshta 60 përqind, mënyra e jetesës nuk është e ni stadi kulturor të dëshirueshëm, që promovon barazinë. Sepse unë jam e vetdijshme, për shembull në ni mënyrë të jetesës, jo primitive, po më t'hershme, ta zëmë, burri ka lavruar, i ka prerë drutë e tjerë, gruaja ka gatuar. Dhe ajo ka qenë mënyra e jetesës sepse ato kanë qenë punë ma t'lehta, i ka bërë gruaja. Tani më nuk ka punë të grave dhe të burrave dhe secili duhet ta bëj punën qe e zotëron më mire, ose që mund ta bëjë më mirë. Tani ke kuzhinierë burra aq shumë, kudo n'botë.

Domethënë edhe... po për t'arritur barazinë kërkohet sa më shumë... të gjitha instirucionet ta promovojnë, sidomos mediat, që nuk e bëjnë. Se mediat më shumë gruan e paraqesin vetëm si pamje, vetëm si veshje, si figurë, si... jo si vlerë intelektuale, ose si vlerë profesionale, ose si... Dhe kjo është detyra edhe e mediale edhe e shkollës edhe e politikës. Ti shikojë për shembull n'parlament, s'ke kryetare t'parlamentit; menxi ni kryetare e shtetit edhe ajo domethanë konteksi e solli, jo pse do ta bënin. Mu m'ka penguar gjithmonë. Për shembull edhe në ndonji manifestim krejt të rëndomtë, vetëm burra shkojnë, vetëm deputetë. Edhe i kom pasë thënë shefit t'Grupit Parlamentar nihere, në ni mbledhje t'Grupit, "Çka është... kjo?. Ju krejt si odë, vetëm... Pse s'na thirrni edhe neve kur shkoni në ndonji manifestim, ose në ndonji..." Dhe ai është deputet. Ai është i thirrur ta promovoj atë... Sepse, domethanë edhe zhvillimi kulturor, edhe emancipimi kulturor, emancipimi i barazisë, nuk mund t'bëhet lehtë edhe shpejt. Frizurën mund ta ndërrosh, edhe fustanin, edhe... po vetëdija ndrron më ngadalë. Dhe për t'u bërë më shpejtë, duhet të gjithë mekanizmat të funksionojnë.

Lura Limani: Veç deshta me ju falenderu... edhe Kaltrinë a ki naj pyetje?

Kaltrina Krasniqi: Jo.

Lura Limani: Me ju falenderu shumë për kohën edhe që i keni nda me neve kto rrëfime edhe t'bukura edhe t'trishtushme, po jashtëzakonisht prekëse.

Sala Ahmetaj: Unë jam e lumtur n'qoftë se kom arritur t'jap ndonji, ni kontribut ose... të vogël edhe për punën tuaj edhe për çkado qoftë tjetër.